



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë më, 17.7.2020

Lënda: Parashtrime të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 17.7.2020, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen me objekt: ankimi ndaj vendimit nr. 103, datë 5.2.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Donika Prele

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5, të Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2, e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 27.3.2019, është njoftuar vendimi nr. 103, datë 5.2.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (*në vijim referuar si Komisioni*), me anë të të cilit është konfirmuar në detyrë subjekti i rivlerësimit znj. Donika Prele, magjistrate/prokurore, në atë kohë drejtuese e Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1, e ligjit nr. 84/2016, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga njoftimi i vendimit, ka ushtruar të drejtën e ankimit, pasi ka vlerësuar se ky vendim është i cenueshëm në tërësinë e tij. Si rrjedhojë, mbi bazën e shkaqeve të ankimit, Komisioneri Publik çmon se juridiksioni kontrollues dhe rivlerësues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (*në vijim referuar si Kolegji*), do të duhet të ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

1. Duke i qëndruar të gjitha shkaqeve të parashtruara në ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit nr.103/2019 të Komisionit, mbështetur dhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, para këtij trupi gjykues parashtrohen për shqyrtim në rastin konkret çështje që lidhen me: **(i)** të ardhurat e ligjshme nga burime të ligjshme, në vështrim të përcaktimit të nenit D, paragrafi 3, të aneksit të Kushtetutës; **(ii)** të ardhurat e ligjshme me burim

nga remitancat (të ardhurat nga emigracioni); (iii) detyrimi për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të pasurisë në rastet e konfirmuara të marrëdhënieve të huas, për subjektin e rivlerësimit, personat e lidhur apo të tjerë të lidhur me të; (iv) detyrimi për të deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasurinë apo interesat private në deklaratat periodike të pasurisë dhe Deklaratën “Vetting”, si dhe (v) çështje të lidhura me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale dhe denoncimet e publikut për subjektin e rivlerësimit.

I. Vlerësimi për kriterin e pasurisë

2. Referuar gjendjes së pasqyruar në momentin e plotësimit të Deklaratës “Vetting” dhe akteve të administruara në dosje, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka në bashkëpronësi me bashkëshortin, dy pasuri të paluajtshme, njëra e llojit “apartment banimi”, me sipërfaqe 95.6 m², e ndodhur në Tiranë, dhe tjetra e llojit “tokë arë”, me sipërfaqe 1.000 m², e ndodhur në ***, Tiranë. Subjekti i rivlerësimit deklaroi po ashtu në bashkëpronësi me bashkëshortin e saj dy automjete, si dhe llogari bankare, njëra prej të cilave me burim krijimi nga shitja e një apartamenti në Durrës.

3. Referuar shkaqeve të ankimit, Komisioneri Publik kërkon kontrollin nga ky trup gjykues të këtyre çështjeve: (A) Ekzistencën e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë “apartment banimi”, me sip. 95.6 m², me nënçështjet përkatëse, që do të trajtohen në vijim; (B) Ekzistencën e burimit të ligjshëm të krijimit të likuiditeteve, llogarisë bankare në shumën 4.501.427,89 lekë, me burim krijimi të deklaruar nga shitja e një apartamenti në Durrës, si dhe (C) Transaksione monetare dhe marrëdhënie huaje të padeklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

4. Komisioneri Publik, përpara se të vijojë me analizën e detajuar të shkaqeve të ankimit, e çmon të nevojshme të nënvizojë disa fakte dhe rrethana të dala nga hetimi administrativ, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në vlerësimin e burimeve të krijimit të pasurive, për të cilat Komisioneri Publik, në referencë tashmë dhe të jurisprudencës së Kolegjit, ndan mendim të ndryshëm nga sa ka konkluduar Komisioni në vendimin konkret nr.103, datë 5.2.2019.

4.1 Kështu, Komisioni gjatë hetimit administrativ ka konstatuar se për vitet 2003-2008, nuk janë paguar të plota sigurimet shoqërore dhe detyrimet tatimore mbi të ardhurat nga pagat e bashkëshortit të subjektit, të ardhura të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurive. Pasi ka administruar provat dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni në vendimin e tij, ndër të tjera, ka konkluduar se: [...] *shtetasi ***.*** vërtetoi në mënyrë të pakontestueshme se marrëdhënia e tij e punësimit është e ligjshme dhe të ardhurat e përfituara kanë qenë nga një marrëdhënie pune e ligjshme. Mospagimi i taksave për një pjesë të të ardhurave në shumën totale prej 2,584,910 lekë ka qenë detyrim i punëdhënësit dhe se ato nuk mund të paguheshin nga vetë subjekti... Subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm faktin se nuk ka pasur dijeni për këtë praktikë të punëdhënësit dhe se bashkëshorti i saj nuk ka bashkëpunuar me punëdhënësin për të shmangur pagimin e detyrimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, por se ai ka qenë i dëmtuar nga ky proces [...].*

4.2 Lidhur me këtë interpretim të Komisionit, Komisioneri Publik sjell në vëmendje se jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit e ka konsoliduar interpretimin e përmbajtjes së dispozitës së pikës 3, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, për përcaktimin e ligjshmërisë së të ardhurave.

4.3 Bazuar në interpretimin gjyqësor të këtyre dispozitave nga ana e Kolegjit, subjektit të rivlerësimit i kërkohet të shpjegojë bindshëm jo vetëm burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruar, por edhe ligjshmërinë e të ardhurave, të ardhura këto të cilat duhet të jenë të krijuara nga burime të ligjshme, të jenë të deklaruar dhe për to të jenë paguar detyrimet tatimore përkatëse¹.

4.4 Komisioneri Publik në qëndrimin e tij i referohet dhe arsytimit të Kolegjit në vendimin (JR) nr. 7/2019, prg. 24, në të cilin specifikisht për të ardhurat e realizuara nga personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit, si e punësuar, janë vlerësuar se duhet të llogariten për aq sa janë deklaruar në organet tatimore dhe jo sa janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në deklaratimet periodike vjetore.

4.5 Në këtë vështrim, bazuar në nenin D, pika 3, të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik vlerëson se të ardhurat, për të cilat nuk provohet se janë paguar detyrime tatimore, nuk mund konsiderohen si të ardhura të ligjshme për qëllim të procesit të rivlerësimit, dhe për pasojë ato nuk duhen konsideruar në analizën financiare të burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për krijimin e pasurive.

4.6 Në vendimin e Komisionit, objekt ankimi ka gjetur pasqyrim po ashtu edhe trajtimi nga ana e Komisionit i elementit subjektiv të personit të lidhur dhe subjektit të rivlerësimit, në lidhje me dijeninë për pagesën ose jo të detyrimeve tatimore, për të ardhurat nga marrëdhënia e punës. Komisioneri Publik vlerëson se ky argumentim nuk gjen mbështetje në rastin konkret referuar provave të administruara, të vëna në dispozicion nga vetë subjekti i rivlerësimit, por edhe në vetë jurisprudencën e Kolegjit.

4.7 Nga aktet rezulton se subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka paraqitur në cilësinë e provës, vetëm listëpagesat e shoqërisë “****” sh.p.k.,² për dy vite me radhë, të cilat, në referencë të verifikimit të dijenisë për sa të ardhura janë përfituar, rezulton se janë të nënshkruara jo vetëm nga punëdhënësi, administratori i shoqërisë, z. ***.***, por edhe nga punëmarrësi, z. ***.***, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit³.

¹ Referohuni vendimit (JR) nr. 6/2019, prg. 21.12; vendimit (JR) nr. 19/2019, prg. 22.13; (JR) 3/2018 prg. 24; (JR) 7/2018 prg. 52; (JR) 32/2019 prg. 56.

² Listëpagesa të viteve 2007 dhe 2008.

³Në kolonat përkatëse të këtyre listëpagesave specifikohet se paga është arkëtuar pjesërisht në llogarinë bankare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit (rreth gjysma e vlerës së deklaruar si pagë neto, ku janë zbritur detyrimet tatimore për këtë vlerë) dhe pjesërisht *cash* në arkën e shoqërisë (gjysma e mbetur e vlerës së deklaruar si pagë neto). Po ashtu nga verifikimi i të dhënave të llogarisë bankare, vërtetuar me shkresën nr. ***, datë ***.4.2018, nga ***, rezulton se bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për periudhën dhjetor 2007- dhjetor 2008, i janë kredituar pranë kësaj banke shumat 20.700 lekë/muaj (me pagesa 15-ditore prej 10.350 lekë), të cilat ndryshojnë nga vlera e pagës prej 50.000 lekë, të parashikuara në kontratat e punës me shoqërinë “****” sh.p.k., të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit dhe të deklaruar në deklaratat e interesave private/periodike.

4.8 Ka rezultuar se një pjesë të pagës së pretenduar, më pak se gjysmën, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit e ka përfituar nga depozitimi në llogarinë e tij bankare. Vetëm për këtë pjesë të pagës, që derdhej në llogarinë bankare, konstatohet se janë paguar detyrimet tatimore. Ndërkohë, diferenca me vlerën e pagës të pasqyruar në kontratën e punës rezulton e tërhequr *cash* nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në arkën e shoqërisë, pa u paguar detyrimet tatimore përkatëse.

4.9 Në këto rrethana, fakti që subjekti edhe gjatë procesit të rivlerësimit ka pretenduar mospasjen dijeni të saj dhe të bashkëshortit, për këtë shmangie të pagimit të detyrimeve tatimore në marrëdhëniet e punës, në periudhën në fjalë, teksa subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e prokurores në seksionin e Task-Forcës pranë organit të Prokurorisë⁴, në këndvështrim të vlerësimit etiko-profesional dhe në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të të tria kritereve sipas nenit 4, pika 2, në lidhje me nenin 61/5, të ligjit nr. 84/2016, shihet si rrethanë rënduese në pozitën e subjektit për qëllim të procesit të rivlerësimit.

4.10 Mbështetur në sa argumentuar më sipër, duke iu rikthyer trajtimit të secilit shkak ankimi, parashtrojmë se:

A. Për sa i përket pasurisë së paluajtshme “*apartment banimi*” me sip. 95.6 m², identifikuar si pasuria me nr. ***, e regjistruar më datë ***.11.2012, në emër të personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit, z. ***.***.

5. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2007 (këtu e në vijim referuar DV-), në të cilën deklarohet për herë të parë kjo pasuri, subjekti i rivlerësimit deklaron: blerje “*apartment banimi*” 2+1. Kontratë porosie, datë ***.5.2007, në emër të ***.***, e pahipotekuar, vlera 32.100 euro. *Burimi i krijimit:* Hua e marrë për blerje apartamenti në shumën 15.000 euro, kontratë verbale me afat 3-vjeçar, marrë nga shtetasi ***.***.

5.1. Në Deklaratën e pasurisë, Shtojca 2 (këtu e në vijim referuar D-Vetting), dorëzuar më datë 25.1.2017, subjekti i rivlerësimit deklaron: “*Apartment banimi*” me sipërfaqe 95.6 m², regjistruar me numër pasurie ***, me numër hipoteke ***, datë ***.11.2012, në emër të bashkëshortit ***.***. *Burimi i krijimit:* (i) të ardhurat e përbashkëta të krijuara nga puna si prokurore dhe të bashkëshortit, ***.***, gjatë viteve 2006 (*kursime të deklaruara 1.000.000 lekë*); (ii) të ardhura të përbashkëta nga puna gjatë vitit 2007, si dhe (iii) hua e marrë nga shtetasi ***.***, djali i xhaxhait të bashkëshortit, në shumën 15.000 euro, me kontratë verbale. Huaja në shumën 15.000 euro është likuiduar në dy këste, 7.500 euro në vitin 2008 dhe 7.500 euro në vitin 2009, nga të ardhurat e krijuara nga puna si prokurore dhe e bashkëshortit, ***.***, për vitet 2008-2009.

6. Komisioneri Publik, në analizë të shkaqeve të ankimit, për vlerësimin e ligjshmërisë së burimit për krijimin e pasurisë “*apartment banimi*”, do të ndalet përkatësisht në këto nënçështje: (i) mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të realizuar kursimet e deklaruara në vitin 2006 (*1.000.000 lekë*); (ii) mundësinë e mbulimit të pagimit të pjesës së mbetur për këtë pasuri, nga të ardhurat e vitit 2007; (iii) mundësinë e krijimit të të ardhurave nga burime të ligjshme të

⁴ Këtë qëndrim e gjejmë të shprehur dhe në jurisprudencën e Kolegjit në vendimin (JR) nr. 6/2019, prg. 21.29.

shtetasit ***.***, për të dhënë hua shumë 15.000 euro; si dhe (iv) mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të shlyer këtë hua me të ardhura nga burime të ligjshme.

6.1 (i) Lidhur me mundësinë financiare për të realizuar kursimet e deklaruara në vitin 2006

6.1.1. Në DV-2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë kursime në *cash* në shumë 1.000.000 lekë, duke deklaruar se: [...] *disponojmë të ardhura në lekë (KESH) të krijuara nga pagat, të padepozituara në institucionet bankare* [...] Këtë deklaram, subjekti i rivlerësimit e sqaron dhe në deklaramet e saj, në pyetësin nr. 2 të Komisionit.

6.1.2. Bazuar në dokumentacionin e administruar, rezulton se të ardhurat e ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj për vitin 2006, janë gjithsej në shumë 1.006.814⁵ lekë. Këto të ardhura nuk mbulojnë shpenzimet vjetore familjare dhe kursimet e deklaruara për një diferencë negative prej – **285.131 lekë**⁶.

6.2. (ii) Lidhur me mundësinë e subjektit për mbulimin e pagesës së kësteve të apartamentit nga të ardhurat e vitit 2007

6.2.1. Në këtë element të deklaramit, fillimisht vlerësohet mbi mundësinë e mbulimit me burime të ligjshme të shumës 500,000 lekë, deklaruar nga subjekti, për periudhën deri në datën 3.5.2007⁷. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, për këtë periudhë, të ardhurat familjare nga burime të ligjshme, deri në datën 3.5.2007, moment në të cilin deklarohet se është bërë pagesa e parë për apartamentin, llogariten në shumë 408,559 lekë⁸. Kjo shumë nuk është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës dhe kursimin e deklaruar deri në këtë datë.

6.2.2. Për pagesën e dytë, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si e kryer në datën 27.12.2007⁹, në vlerën 5,000 euro (600,000 lekë), me burim kursimet nga pagat deri në fund të vitit 2007, rezulton se të ardhurat e ligjshme për subjektin dhe bashkëshortin e saj, për periudhën maj – dhjetor 2007, janë në shumë 807,318 lekë¹⁰. Nga analiza financiare, rezulton se këto të ardhura nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës dhe shlyerjen e shumës prej 5,000 euro (600,000 lekë), të kështit të dytë, sikurse deklaron subjekti.

6.2.3. Në vlerësim të sa më sipër, në analizë të deklarameve për gjithë shpenzimet e vitit 2007, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshorti, nuk mbulojnë me të

⁵ Sipas vërtetimit datë ***.1.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, mbi të ardhurat neto të subjektit për vitin 2006, në shumë 826.814 lekë dhe vërtetimit nga ISSH nr. *** prot., datë ***.7.2018, mbi të ardhurat e bashkëshortit të subjektit në shumë 180.000 lekë, nga shoqëria “****” sh.p.k.

⁶ Në analizë financiare janë marrë në konsideratë përveç të ardhurave të ligjshme dhe shpenzimeve të jetesës, edhe shuma e akumuluar në llogarinë bankare të subjektit pranë ***.*** Bank, dokument i depozituar nga vetë subjekti gjatë hetimit administrativ.

⁷ Referuar përgjigjeve të subjektit në pyetësin nr. 2.

⁸ Sipas vërtetimit datë ***.1.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe vërtetimit nga ISSH, nr. *** prot., datë ***.7.2018, mbi të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga shoqëria “****” sh.p.k.

⁹ Referuar përgjigjeve të subjektit në pyetësin nr. 2.

¹⁰ Sipas vërtetimit datë ***.1.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe vërtetimit nga ISSH nr. *** prot., datë ***.7.2018, mbi të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga shoqëria “****” sh.p.k.

ardhura të ligjshme pagesën e shumës prej 1,100,000 lekë, deklaruar¹¹ si e paguar në vitin 2007 me burim nga të ardhurat e pagës, për një diferencë negative prej - **450,240 lekë**.

6.3. (iii) Lidhur me mundësinë e krijimit të të ardhurave nga burime të ligjshme të shtetasit *.***, për të dhënë hua shumën 15.000 euro**

6.3.1. Subjekti i rivlerësimi në DV-2007 ka deklaruar hua në shumën 15.000 euro, marrë nga shtetasi ***.***, me kontratë verbale, pa interes dhe me afat 3-vjeçar. Subjekti ka deklaruar se në momentin e huadhënies, bashkëshorti i saj ka lëshuar një deklaratë dore për pranimin e huas, e cila është asgjësuar me likuidimin e kësaj shume¹².

6.3.2. Për të provuar marrëdhënien e huas, subjekti i rivlerësimi ka paraqitur deklaratën noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., e datës ***.2.2016, në të cilën shtetasi ***.*** ka deklaruar se, më datë ***.5.2007, i ka dhënë hua pa asnjë lloj interesi shtetasit ***.*** shumën 15.000 euro, me afat trevjeçar¹³. Komisioneri Publik konstaton se si marrja, po ashtu edhe kthimi i kësaj huaje, deklarohen të jenë kryer jashtë sistemit bankar dhe subjekti i rivlerësimi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion justifikues ligjor për këtë qëllim, në referencë kjo të nenit 32/1 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikave 15, 18 dhe 21, të udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, dalë në zbatim të këtij ligji.

6.3.3. Komisioneri Publik konstaton se deklarata noteriale e vënë në dispozicion nga subjekti për të provuar marrëdhënien e huas, është hartuar kohë më pas (në vitin 2016) nga lindja e marrëdhënies së huas (viti 2007) dhe është paraqitur nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimi. Për sa më sipër argumentuar, në vlerësimin e Komisionerit Publik, deklarata nuk është hartuar, kur ka qenë detyrim ligjor i subjektit deklarues, në mënyrë që të merret në konsideratë në procesin e rivlerësimi, në referencë kjo të jurisprudencës së Kolegjit në vendimin (JR) nr. 10/2018 (prg. 37).

6.3.4. Për sa i përket ligjshmërisë së burimeve financiare të huadhënësit, Komisioneri Publik, në konsideratë të përcaktimit të nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi situatën financiare të z. ***.*** për të justifikuar shumën e dhënë hua. Subjekti i rivlerësimi ka pretenduar se burimi i kësaj huaje, janë: (i) të ardhurat e përfituara nga huadhënësi prej punës së tij si emigrant në shtetin grek, (ii) likuiditetet që ka pasur ky shtetas në llogarinë e tij bankare në dhjetor të vitit 1997, si dhe (iii) të ardhurat e tij nga pagat, duke paraqitur dhe dokumentet përkatëse në cilësinë e provës për këtë qëllim¹⁴.

¹¹ Referuar pyetësorit nr. 2.

¹² Referuar përgjigjeve të pyetësorit nr. 2.

¹³ Në të njëjtën deklaratë, z. ***.*** deklaroi edhe huan dhënë bashkëshortit të subjektit të rivlerësimi, në shumën 1.000.000 lekë në vitin 2009, përdorur nga subjekti si garanci për vizë pranë Ambasadës Amerikane, për të cilën, në vlerësimin e Komisionerit Publik, edhe në këtë rast, dokumentet e administruara nuk provojnë mundësinë e krijimit të të ardhurave nga burime të ligjshme të shtetasit ***.***.

¹⁴ Subjekti ka paraqitur si dokumentacion justifikues: (i) Vërtetime lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Greqi dhe vërtetim nga Dega C Vendore e Punonjësve të Aitolokarnanisë nr. prot.***, datë ***.1.2019, sipas së cilit vërtetohet fakti se shtetasi ***.*** ka punuar në shtetin grek dhe ka realizuar të ardhura për të cilat janë paguar detyrimet (sigurimet shoqërore) për total 290 ditë, periudha 1998-2001, në shumën 1,175,000 dhrahmi greke; (ii) Vërtetime nga Autoriteti Portual Durrës për punësimin e shtetasit ***.***, sipas së cilit ky shtetas për periudhën 2004-prill 2007 ka realizuar të ardhura neto nga pagat në shumën 1.024.972 lekë; (iii) Vërtetim nga *** me nr. prot., ***, të datës ***.1.2019, nga i cili rezulton se në datën 31.12.1997, gjendja e depozitës në emër të këtij shtetasi, ka qenë në shumën 2,464,313 lekë; (iv) Kontratë e datës ***.4.2003, nr. *** rep., nr. *** kol., me objekt shitblerje trualli.

6.3.5. Komisioneri Publik, në analizë të këtyre provave të administruara, si dhe në konsideratë të jurisprudencës të Kolegjit në vendimin (JR) nr. 12/2018 (prg. 22 dhe 22.1) dhe (JR) nr. 6/2019 (prg. 20.11) lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave nga emigracioni, vlerëson se me qëllim që remitancat të vlerësohen në procesin e rivlerësimit, nevojitet që ato të provohen se janë dërgesa vlerash monetare të emigrantëve shqiptarë në vendin e origjinës, të cilat janë realizuar nga burime të ligjshme dhe për të cilat janë përmbushur detyrimet përkatëse tatimore në vendin e krijimit.

6.3.6. Nga analiza e akteve të paraqitura mbi të ardhurat e ligjshme të shtetasit z. ***.***, deri në momentin e huadhënies së deklaruar, rezultojnë se të ardhurat e dokumentuara nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës, investimet e kryera¹⁵ nga vetë z. ***.*** dhe njëkohësisht dhe huan e deklaruar dhënë subjektit.

6.3.7. Për sa i përket pretendimeve mbi ekzistencën e kursimeve në llogarinë bankare të huadhënësit në vitin 1997, pas këtij viti nuk rezulton të jetë paraqitur asnjë dokument provues se ku janë mbajtur këto mjete financiare, nisur nga fakti se subjekti vetë deklaroi se ato janë tërhequr si shkak i trazirave në atë kohë nga shtetasi ***.***. Në vlerësim të këtyre fakteve, si dhe nisur nga koha relativisht e gjatë nga viti 1997 deri në vitin 2007, kur deklarohet huaja e marrë, ky pretendim i subjektit është jo i besueshëm.

6.3.8. Në vlerësim të sa më sipër, vlerësojmë se subjekti nuk provoi mundësinë e personave të tjerë të lidhur për të mbuluar me burime të ligjshme huan e deklaruar.

6.4 (iv) Lidhur me mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të shlyer huan në shumën 15,000 euro, me të ardhura nga burime të ligjshme

6.4.1 Rezulton se subjekti i rivlerësimit në DV-2008 dhe 2009, ndër të tjera, ka deklaruar shlyerjen e huas ndaj shtetasit z. ***.***, në shumat 7,500 euro në dhjetor të vitit 2008 dhe 7,500 euro në dhjetor të vitit 2009. Nisur nga këto deklarime të subjektit, është analizuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, për të shlyer me të ardhura të ligjshme huan e deklaruar.

6.4.2 Nga analiza financiare e kësaj periudhe, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura nga burime të ligjshme shpenzimet e vitit 2008, përfshirë dhe shlyerjen e deklaruar të huas, për një diferencë negative - 405,697 lekë.

7. Në konkluzion të sa më sipër, për pasurinë “apartament banimi” me sip. 96.5 m², konstatojmë se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura nga burime të ligjshme blerjen e këtij apartamenti, për diferencën negative - 2.562.071 lekë, duke rezultuar në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm dhe të pasaktë, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3, e ligjit nr. 84/2016.

8. Për sa i përket, likuiditeteve/llogarisë bankare në shumën 4.501.427,89 lekë, me burim krijimi të deklaruar nga shitja e një apartamenti në Durrës

15 Sipas akteve në dosje, rezulton se z. ***.*** ka investuar në pasuri të paluajshme në periudhën 1998-2001, në shumën 3.950.000 lekë.

8.1 Në *D-Vetting*, subjekti ka deklaruar: Llogari bankare në shumën 4.501.427,89 lekë, pranë ***-së, në emër të z. ***.***. Kjo llogari bankare është krijuar me *burim krijimi*: (i) shitja e apartamentit me sip. 59.2 m², në lagjen nr.***, ***, Durrës, si dhe (ii) kursimet nga paga e të dy bashkëshortëve gjatë viteve, depozituar në bankë më datë 29.2.2016.

8.2 Në DV-2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Blerje apartamenti me sipërfaqe 59.2 m² në lagjen nr. ***, ***, Durrës, në vlerën 1,400,000 lekë, me anë të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., e datës ***.2.2014, në shumën 1.400.000 lekë. Për burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit deklaron: [...] *kursime nga të ardhurat e krijuara në vitin 2015 përfshirë dhe ato të deklaruara në vitin 2014 dhe më parë 1.200.000 lekë gjendje cash. Sqarojmë se nga kursimet është realizuar blerja e apartamentit [...].* Subjekti në të njëjtën deklaratë ka deklaruar: [...] *shitja e apartamentit të mësipërm me vlerën 4.000.000 lekë [...].*

8.3 Referuar përmbajtjes së kontratës së blerjes së pasurisë “apartament” në Durrës, në cilësinë e palës blerëse rezulton z. ***.*** dhe palës shitëse ish-punëdhënësi i tij, shoqëria “****” sh.p.k. Regjistrimi fillestar i kësaj pasurie, në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., rezulton në datën ***.1.2014. Konstatohet se çmimi i blerjes së këtij apartamenti në vlerën 1.400.000 lekë, është ndjeshëm më i ulët, jo vetëm se çmimet e referencës së zonës kadastrale, ku ndodhet pasuria, por edhe nën koston e ndërtimit.

8.4 Ky apartament është blerë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në vlerën 23.648 lekë/m², ndërkohë referuar udhëzimit nr. 1, datë 8.5.2013 të EKB-së, çmimi i shitjes është 74.000 lekë/m², ndërsa kostoja e ndërtimit, sipas të njëjtës udhëzim rezulton në vlerën 36.203 lekë/m².

8.5 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjeve të Komisionit mbi diferencën e çmimit, ka pretenduar se ky çmim është dhënë në vlerë të tillë, referuar marrëdhënies së punës midis bashkëshortit të saj dhe administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k. dhe një marrëveshjeje verbale mes tyre.

8.6 Për të vërtetuar këtë fakt të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, mesa duket në kuadër të hetimit të fiktivitetit të çmimit, Komisioni ka administruar përgjigjen e shoqërisë “****” sh.p.k., me nr. *** prot., datë ***.9.2018, në të cilën administratori i kësaj shoqërie shprehet se: [...] *çmimi i përcaktuar në vlerën 10.000 euro (1.4 milion lekë) nuk është çmim favorizues, por çmim i përcaktuar me marrëveshje verbale për shkak të punësimit të ***.*** si inxhinier ndërtimi në objektin ku ndodhet apartamenti [...].* Në të njëjtën deklaratë, administratori i shoqërisë sqaron se [...] *sipas marrëveshjes që kam pasur me shtetasin ***.***, nëse ai do të qëndronte deri në përfundim të ndërtimit të objektit, apartamenti do t'i llogaritej si vlerë e pagesës së punës së kryer krahas pagës neto me 100.000 lekë/muaj. Meqenëse në muajin dhjetor 2011 ai është larguar nga drejtimi i punimeve, është përcaktuar çmimi i shitjes prej 10.000 euro [...].*

8.7 Nga verifikimi i akteve në dosje, rezulton se në kontratën e punës, datë ***.8.2010, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe z. ***.***, nuk parashikohen kushtet e mësipërme të pretenduara nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe nga provat e paraqitura gjatë procesit të rivlerësimit.

8.8 Ndërkohë, lidhur me burimin e krijimit të këtij apartamenti, Komisioneri Publik ka kryer analizën financiare për të vlerësuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të realizuar kursimet *cash* të deklaruara në vitet 2010-2011, që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, deklaruar respektivisht 500.000 lekë në vitin 2010 dhe 1.500.000 lekë në vitin 2011.

8.9 Nga përlllogaritjet,¹⁶ rezulton se subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e deklaruara në vitin 2010 për një diferencë negative prej **-319,128.64 lekë**, si dhe shpenzimet dhe kursimet e deklaruara në vitin 2011, për një diferencë negative prej **-1.260.035 lekë**.

8.10 Në konkluzion të sa më sipër, mbi blerjen e pasurisë apartament në Durrës, shitja e së cilës ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë depozitë bankare, rezulton se subjekti nuk mbulon me të ardhura të ligjshme blerjen e apartamentit në Durrës, për një shumë totale negative prej **-1,579,163.64 lekë**.

8.11 Në total, në referencë të nenit D, pikat 1 dhe 3 të aneksit të Kushtetutës, nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, nuk mbulojnë me burime të ligjshme krijimin e pasurive të deklaruara për një diferencë totale negative prej **-4.141.233 lekë**, duke qenë kështu në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm dhe të pasaktë për kontrollin e pasurisë.

9. Transaksione monetare dhe marrëdhënie huaje të padeklaruara nga subjekti i rivlerësimit

9.1 Mosdeklarimi i një huaje prej 25.000 euro

9.1.1 Referuar dokumentit “Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit D. Prela”, të ILDKPKI-së me nr. *** prot., datë ***.2.2018, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti i saj, z. ***.***, nuk kanë deklaruar një marrëdhënie huaje në shumën prej 25.000 euro në DV-2011, ashtu edhe kthimin (marrjen) e shumës 25.000 euro në DV-2014.

9.1.2 Mbi ekzistencën e kësaj marrëdhënie huaje dhe mosdeklarimit të saj nga subjekti i rivlerësimit, nga aktet në dosjen e Komisionit, rezulton se ILDKPKI-ja është vënë në dijeni nga një komunikim zyrtar me Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit të Parave (DPPP), ku kjo e fundit, me anë të shkresës nr. *** prot., datë ***.5.2017, ka referuar se për z. ***.*** është identifikuar një transaksion bankar, tërheqje *cash*, në shumën 20.000 euro, më datë ***.6.2014, në llogarinë e tij pranë *** Bank.

¹⁶ Në përlllogaritje janë marrë parasysh si të ardhura të ligjshme vetëm të ardhurat e subjektit të rivlerësimit sipas vërtetimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, datë ***.1.2017, pasi ISSH-ja, me shkresën nr. ***, datë ***.7.2018, lidhur me të ardhurat e bashkëshortit, konfirmon se për periudhën shkurt 2009 - dhjetor 2011, emri i kërkuar (i bashkëshortit të subjektit) nuk figuron në listëpagesa. Në shpenzime janë llogaritur shpenzimet e jetesës sipas standardit të përdorur nga KPK-ja mbështetur në të dhënat e INSTAT-it, shpenzimet për mobilim sipas deklarimit të subjektit, pagesat për studime master përfshirë dhe rimbursimin e shumës sipas deklarimeve të vetë subjektit, shpenzimet e udhëtimit sipas të dhënave të sistemit TIMS, llogaritur mbështetur në metodologjinë e përdorur nga Kolegji, shpenzimet e deklaruara nga bashkëshorti për pagesën e detyrimeve për shoqërinë ***.*** Konstruktion.

9.1.3 *** Bank i ka referuar ILDKPKI-së se shtetasi ***.*** ka qenë përfitues i një shume nga kredia e miratuar nga kjo bankë për subjektin “***” sh.p.k. (një ndër ish-punëdhënësit e z. ***.***) me administrator z. ***.***. Për të shmangur rrezikun që kjo kredi të mos përdorej jashtë objektit të saj, disbursimi i limitit të kredisë të miratuar për shoqërinë “***” sh.p.k. do të kryhej direkt nga banka në llogari të palëve të treta (huadhënësve), përfshirë këtu dhe personin e lidhur, ***.***, për të mbyllur debitimet që ka pasur shtetasi ***.***¹⁷ kundrejt tyre.

9.1.4 Referuar lëvizjeve të llogarisë bankare të personit të lidhur ***.***, të konfirmuara nga *** Bank, me shkresën nr. ***, datë ***.6.2017, rezulton se në datën 18.6.2014, është disbursuar nga banka shuma prej 25.000 euro, e cila është tërhequr 5.000 euro, në datën 19.6.2014 dhe 20.000 euro në datën 20.6.2014, tërheqje të kryera nga vetë z. ***.***. Në korrespondencën me ILDKPKI-në, administruar si pjesë e akteve të hetimit administrativ të Komisionit, në lidhje me verifikimin e ekzistencës së marrëdhënies së huas mes bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe z. ***.***, *** Bank ka vënë në dispozicion gjithashtu edhe:

- Deklaratën noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.9.2011, të deklaruesve ***.*** dhe ***.***, ku ***.*** deklaroi se: [...] *“kam marrë hua me datën e sotme nga ***.*** shumën 10.000 euro, për një periudhë **njëvjeçare**, duke filluar nga data e sotme, 14.9.2011, dhe deri më 14.9.2012, me **një interes mujor në masën 2%**”*[...].
- Deklaratë shkresore e datës 22.9.2011, nënshkruar nga ***.*** dhe ***.***, ku ***.*** deklaroi se i ka marrë hua në datën e nënshkrimit të kësaj deklarate ***.***, shumën 15.000 euro, për një periudhë **njëvjeçare me interes mujor 2%**. Nënshkrimet në këtë deklaratë janë vërtetuar sipas ligjit nga noteri publik ***.***, më datë ***.10.2013.
- Marrëveshje shtesë e Kontratës për Kufi Kredie Shumëqëllimore¹⁸ me nr. *** rep., nr. *** kol., e datës ***.6.2014, ndërmjet *** Bank (kredidhënësi) dhe ***.*** (kredimarrësi).

9.1.5 Gjatë hetimit administrativ, Komisioni¹⁹ ka kërkuar nga subjekti i rivlerësimit të dhëna mbi burimin e shumës së dhënë hua prej 25.000 euro dhe dokumentin mbështetës në lidhje me dhënien dhe kthimin e kësaj huaje. Në përgjigje të kësaj kërkesë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: [...] *Për sa i përket huas që bashkëshorti im ka dhënë borxh në vitin 2011 shtetasi ***.***, në shumën 25.000 euro, pasi u njoha me pyetjen e bërë nga ana juaj, nga komunikimi me bashkëshortin ***.***, erdha në dijeni se këtë shumë bashkëshorti im e ka dhënë hua duke vepruar si përfaqësues me prokurë i shtetasi ***.***, kushëriri i tij. Kjo shumë nuk është pasuri, e cila i përket bashkëshortit tim, ***.***, apo na përket ne si familje. Konkretisht, për shkak të marrëdhënies së posaçme punëdhënës – punëmarrës, që bashkëshorti im, ***.***, ka pasur me shtetasin ***.*** si administrator i shoqërisë “***” sh.p.k., në vitin 2011 shtetasi ***.*** dhe shtetasi ***.***, djali i xhaxhait të bashkëshortit, kanë biseduar, që ky i fundit t’i jepte hua shumën 25.000 euro [...].*

9.1.6 Në mbështetje të pretendimit të mësipërm, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në Komision:

¹⁷ Referuar edhe nenit 3, të Kontratës për Kufi Kredie Shumëqëllimore me nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.6.2014, me kredimarrës ***.***.

¹⁸ Në vijim të Kontratës për Kufi Kredie Shumëqëllimore me nr. *** rep.../2014.

¹⁹ Referohuni pyetësorit nr. 3.

- Prokurën e posaçme noteriale nr.*** rep., nr. *** kol., datë ***.7.2011, me anën e së cilës ***.*** ka caktuar si përfaqësues ligjor të tij ***.***;
- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr.*** kol., datë ***.9.2018, e z. ***.***;
- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr.*** kol., datë ***.9.2018, e z. ***.***.

9.1.7 Lidhur me burimin e shumës së dhënë hua, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion disa dokumente fotokopje të përkthyer dhe noterizuara mbi qëndrimin e shtetasit ***.*** në shtetin italian, si dhe të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja e tij nga punësimi në këtë shtet.

9.1.8 Në vlerësim të fakteve të mësipërme, Komisioni ka konkluduar se: [...] *Këto veprime, z. ***.*** i ka kryer me prokurën e posaçme të datës ***.7.2011, të deklaruar edhe në DPV përkatës. Po ashtu është deklaruar dhe dokumentuar nga hetimi se shtetasi ***.*** ka pasur burime financiare të mjaftueshme dhe nga burim i ligjshëm, për dhënien e kësaj huaje shtetasit ***.*** (administrator i shoqërisë “***” sh.p.k.), ku z. ***.*** ka qenë i punësuar. Huadhënia nuk është deklaruar, pasi nuk ka qenë pjesë e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe e bashkëshortit të saj²⁰[...].*

9.1.9 Nga analiza e akteve në dosje, referuar dhe raportit të ILDKPKI-së, Komisioneri Publik konstaton se marrëdhënia e huas mes bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit ***.***, edhe në referencë të prokurës së posaçme të korrikut 2011, nuk rezulton të jetë deklaruar në asnjë prej deklaratave periodike vjetore DV-2011-2014 ose në D-Vett. Prokura nr.*** rep., nr. *** kol., datë ***.7.2011, është administruar si akt, vetëm gjatë hetimit administrativ të Komisionit, megjithëse daton nga korriku 2011. Gjithashtu, konstatohet se dy deklaratat noteriale, ajo e z. ***.*** dhe e z. ***.***, janë hartuar pas njohjes së subjektit me rezultatet e hetimit administrativ, të dyja në datën ***.9.2018.

9.1.10 Referuar deklaratave të referuara më lart (*sjellim në vëmendje që ky dokumentacion është vënë në dispozicion vetëm nga korrespondenca e ILDKPKI-së me *** Bank*) rezulton se afati i huas është njëvjeçar dhe me interes mujor 2%. Ndërkohë, sipas lëvizjes së llogarisë të shtetasit ***.***, vënë në dispozicion nga *** Bank dhe sipas deklarimeve të subjektit në pyetësorin nr. 3, rezulton se bashkëshorti i saj ka qenë palë kreditore në këtë marrëdhënie deri në qershor të vitit 2014 (pra për gati tre vjet), kur është bërë dhe kthimi i shumës 25.000 euro në llogarinë bankare në emër të tij, në *** Bank.

9.1.11 Sa më sipër, referuar akteve ligjore (deklaratë noteriale, deklaratë shkresore, vërtetuar nënshkrimi nga noteri publik) rezulton se personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe palët deklaruese, në asnjë moment, nuk kanë deklaruar faktin se huadhënësi, ***.***, po vepron në emër të ***.***, sikurse pretendohet nga prokura e posaçme e korrikut 2011, administruar gjatë procesit të rivlerësimit nga Komisioni.

9.1.12 Në vlerësim të Komisionerit Publik, rrethanat e mësipërme faktike dhe pozita juridike në cilësinë e kreditorit, e z. ***.***, duhet të deklaroheshin nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të/bashkëshorti i saj, në zbatim të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, të ndryshuar,

²⁰ Referuar prg. 95, 96 dhe 97 të vendimit të Komisionit.

si dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, duke bashkëngjitur dhe dokumentin ligjor, prokurën e posaçme, mbi bazën e të cilit sqarohet burimi i krijimit të shumës, shkakun pse e posedonin atë dhe faktin se vepronin në emër të një personi të tretë.

9.1.13 Për këtë qëllim, Deklarata e Interesave Private Periodike/Vjetore, në faqen 11 të saj, rubrika mbi të dhënat konfidenciale, ndër të tjera, sqaron se ngarkon subjektet deklaruese me përgjegjësinë ligjore për deklarimin me korrektësi dhe vërtetësi mbi të dhënat konfidenciale në lidhje me identitetin e personit juridik ose fizik huadhënës a huamarrës, emërtesën e institucionit publik ose privat me të cilët ka marrëdhënie interesi, duke specifikuar kështu edhe dokumentin ligjor mbi bazën e të cilit rregullohet kjo marrëdhënie.

9.1.14 Lidhur me dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës 25.000 euro, referuar kërkesave të K. Pr. Civile, legjislacionit në fuqi dhe praktikës së Kolegjit²¹, konstatojmë se dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit mbi të ardhurat e shtetasit ***.*** nuk kanë elementet e nevojshme për t'u pranuar si provë për shkak të mangësive në formë.

9.1.15 Ndodhur në këto rrethana ligjore dhe fakte, në rast se diferencës negative që ka rezultuar nga vetë deklarimet e subjektit të rivlerësimit në Deklaratën “Vetting” do t'i shtohet dhe kundërvlera në lekë e shumës 25.000 euro, që rezulton dhënë hua nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në shtator 2011, prej 3.510.950 lekë, pamjaftueshmëria financiare e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për mbulimin e shpenzimeve, investimeve dhe huadhënies, rezulton me një diferencë totale negative prej **-7.652.183 lekë**.

9.1.16 *Ndërkohë, mbi bazën e akteve të administruara dhe rrethanave që paraqet kjo marrëdhënie huaje, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në posedim ose përdorim të tij, në kuptim të nenit D, pika 5, të aneksit të Kushtetutës.*

9.2 Transaksion bankar/pagesë cash në shumën 1.755.000 lekë, viti 2013, kryer nga personi i lidhur, z. *.*****

9.2.1 Nga dokumenti “Akti përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Donika Prela”, i ILDKPKI-së, me nr. *** prot., datë ***.2.2018, rezulton gjithashtu²² se me anë të shkresës nr. *** prot., datë ***.5.2017, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit të Parave (DPPP), informon ILDKPKI-në se, për z. ***.***, është identifikuar një transaksion bankar i datës 24.4.2013, në shumën 1.755.000 lekë, i kryer pranë Bankës ***.*** (sot *** Bank), me përshkrim veprimi: kreditim llogarie.

9.2.2 Lidhur me këtë transaksion, nga banka sqarohet se veprimi është kryer ndërmjet ***.*** dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Burimi i të ardhurave të deklaruara për efekt të këtij transaksioni është: shitja e apartamenteve. Më tej sqarimi vijon se: “Veprimet janë kryer në sportelin e Bankës pranë ZVRPP Durrës”.

²¹ Në këtë drejtim mbajmë në konsideratë edhe praktikën e KPA-së, vendimi (JR) nr. 9/2018, prg.101.

²² Faqe 14 dhe 15 e këtij raporti.

9.2.3 Komisioni, me shkresën nr.*** prot., datë ***.10.2018, ka kërkuar informacion nga *** Bank, dhe kjo e fundit, me shkresën nr. *** prot., datë ***.11.2018, ka vënë në dispozicion të Komisionit: (i) mandatarkëtimin e datës ***.4.2013 për derdhjen e shumës 1.755.000 lekë, nga z. ***.***, në favor të ZVRPP Durrës, (ii) deklaratën e burimit të të ardhurave plotësuar në datën ***.4.2013, ku në seksionin mbi deklarimin e burimit të shumës së depozituar është shkruar nga z. ***.*** me shkrim dore: “*shitja e apartamenteve nga ***.*** (administrator i firmës)*”, si dhe (iii) kopjen e mjetit të identifikimit të shtetasit ***.***.

9.2.4 Nga aktet e administruara nuk provohet lidhja, shkak ligjor dhe qëllimi i kryerjes së transaksionit nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit pranë ZVRPP Durrës, në muajin prill të vitit **2013**, periudhë në të cilën bashkëshorti i subjektit ka qenë i punësuar pranë Bashkisë Tiranë, ndërkohë që marrëdhëniet e punësimit me shoqërinë “****” sh.p.k. ishin ndërprerë prej nëntorit të vitit **2011**²³.

10. Komisioneri Publik, për sa më sipër trajtuar, duke përfunduar për kontrollin e kriterit të pasurisë, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe jo në përputhje me ligjin, në kuptim të pikës 1, 3 dhe 5 të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “a” dhe “b” dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016.

11. Çështje të tjera të lidhura me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale dhe denoncimet e publikut për subjektin e rivlerësimit

11.1 Nisur nga fakti që Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, Komisioneri Publik çmon të parashtrijë gjetjet përkatëse të këtyre akteve, lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale dhe denoncimeve të ardhura pranë IKP-së, pas datës së depozitimit të ankimit.

11.2 Të dhëna nga raporti mbi vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, përgatitur nga Prokuroria e Përgjithshme

11.2.1 Në zbatim të nenit E të aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar dhe analizuar raportin mbi vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Nga raporti është konstatuar se për dy nga pesë dosjet penale e përzgjedhura, dy çështje të ndjekura nga subjekti (dosja nr. 4 dhe 5), që kanë pasur për objekt të njëjtën veprë penale, atë të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, “*Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt*”, janë ndjekur standarde të ndryshme hetimi. Në rastin e dosjes nr. 4, për të pandehurin, shtetasin ***.***, është proceduar në kushtet e masës së sigurimit, “arrest në burg”, ndërsa për dosjen nr. 5, i pandehuri ***.***, për të njëjtën veprë penale, është proceduar në gjendje të lirë, pa u kërkuar masë sigurimi nga ana e Prokurorisë.

11.2.2 Njëkohësisht me gjetjet nga raporti i vlerësimit profesional, Komisioni ka hetuar edhe raste të denoncimeve nga publiku dhe media, për të cilat është marrë qëndrimi i subjektit, janë

²³ Fakt i konfirmuar nga ***.***, në dokumentin e protokolluar pranë Komisionit me nr. prot. ***, datë ***.9.2018.

administruar edhe gjetjet e ONM-së mbështetur në nenin B, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 49, pika 10, të ligjit nr. 84/2016 dhe, përfundimisht, Komisioni ka konkluduar se deri në atë moment nuk ekzistonte asnjë indicie serioze që mund të çonte në rihapjen e hetimeve.

11.2.3 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, elementet e mësipërme, të konstatuara nga aktet në dosje të Komisionit, janë elemente që duhen konsideruar nga Kolegji në rivlerësimin e subjektivit, znj. Donika Prela, bazuar në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas nenit 4, pika 2 dhe nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

11.3 *Të dhëna nga denoncimet e ardhura pas depozitimit të ankimit*

11.3.1 Kolegji i Posaçëm i Apelit, me shkresën nr. *** prot., datë ***.6.2020, ka përcjellë pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, denoncimin me nr. *** prot., datë ***.6.2020, që i përket shtetasit ***.***, ardhur pranë Kolegjit bazuar në nenin 53, “*Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e fakteve*”, të ligjit nr. 84/2016.

11.3.2 Ky shtetas, ndër të tjera, pretendon se Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), në përgjigje të kërkesës së tij për informacion mbi ecurinë e kallëzimit penal të depozituar nga ana e tij *për vjedhjen në vitin 2013 të 11 bondeve në zyrën e shqiptaro-kroatit ***.****, me shkresën nr. *** prot. /***.***, datë ***.6.2020, ka bërë me dije se në SPAK nuk ka të regjistruar ndonjë procedim penal mbi bazën e ndonjë kallëzimi penal të kryer nga ana e tij.

11.3.3 Denoncuesi në vijim ka kallëzuar pranë kësaj Prokurorie, ndër të tjerë, subjektin e rivlerësimit, ish-drejtuese e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, për shpërdorim detyre, zhdukje të shkresave zyrtare dhe të kallëzimeve të tij, në bazë të nenit 25, 248, 313/a të K. P. dhe nenit 79, 280, 283 të K.P.P.

11.3.4 Nga aktet rezulton se ky shtetas ka paraqitur *ankesë të përsëritur* dhe pranë Prokurorit të Përgjithshëm, ku, ndër të tjera, pretendon se zhdukjen e kallëzimeve të bëra nga ana e tij e dokumenton dhe me një sërë aktesh, të identifikuar në ankesën e paraqitur, me numër protokolli dhe me datë, si dhe *duke bashkëngjitur, për të disatën herë*, kallëzimin që ka datën ***.5.2013.

11.3.5 Komisioneri Publik vlerëson se në dukje ky denoncim përmban informacione që mund verifikohen, në kuadër të vlerësimit tërësor, në përputhje me nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në procesin e rivlerësimit, brenda kuadrit të procedurës gjyqësore të apelit dhe mbeten për t’u çmuar nga trupi gjykues i Kolegjit të Apelit.

II. Konkluzione

12. Nisur nga dispozitat e nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, referuar sa ka disponuar Komisioni në rastin konkret, në gjendjen që janë faktet dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ, në zbatim të jurisprudencës së Kolegjit, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt me Komisionin, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

13. Mbështetur në parashikimet e nenit F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkojmë që shkaqet parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, në përfundim të gjykimit të çështjes, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 103, datë 5.2.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Donika Prela.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA